



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
*Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice*

**Titulli i prezantimit**

**ROLI DHE ZBATIMI I LIGJIT PËR AZILIN SI DHE RAPORTI I TIJ ME  
KONVENTËN NDËRKOMBËTARE PËR AZILIN**

Përgatitur nga:

**Hasan Shala, Gjyqtar i Gjykatës së Apelit në Kosovë**

Prishtinë, 04 Maj 2022

## **HYRJE**

Hyrje

Objektivat e të mësuarit

Metodat e të shpjeguarit

Përmbledhja

## **OBJEKTIVAT MËSIMORE**

Pas përfundimit të këtij prezantimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

1. Të kuptojnë mënyrën e ushtrimit të kërkesës për azil nga azilkërkuesi nocionet dhe institucionet themelore të procedurës të konfliktit administrativ.
2. Të bëjnë dallimin në mes të kërkesës për azil dhe ushtrimit të ankesës ndaj vendimit të DSHAM-së.
3. Të shpjegojnë çështjet që kanë të bëjnë me inicimin dhe procedurat në konfliktin administrativ, për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën e azilit.

## **METODOLOGJIA**

Ndër metodat kryesore që do të përdoren gjatë trajnimit janë: ligjërimi i pjesshëm teorik, diskutimet interaktive, të cilët do të mbrojnë dhe argumentojnë qëndrimet të ndryshme dhe analizë kritike të dispozitave ligjore nga praktika. Materiali teorik është strukturuar në mënyrë që koha me e madhe tu lihet debateve dhe diskutimeve me pjesëmarrësit.

## **PRITSHMËRITË PËR PJESËMARRËSIT**

Pjesëmarrësit pritet të jenë aktiv përgjatë gjithë trajnimit, duke bërë pyetje, duke dhënë komente, duke marr pjesë në diskutime etj., në mënyrë që të sqarohen të gjitha çështjet kryesore të këtij moduli dhe të thellohen njohuritë dhe shkathtësitë e tyre praktike për të gjitha elementet themelore të çështjeve që diskutohen, si dhe në të njëjtën kohë të jenë në gjendje që t'i zbatojnë në mënyre të suksesshme ato njohuri për punë e tyre në praktikë.

**Burimet:**

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës,
2. Konventa e OKB e vitit 1951 dhe Protokollit i vitit 1967, në lidhje me Statusin e Refugjatëve;
3. Ligji për Azilin i Kosovës nr. 06/L-026;
4. Ligji për Konfliktet Administrative nr.03/L-202 dhe
5. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

## **PROCEDURAT LIDHUR ME KËRKESËN PËR TË DREJTËN E AZILIT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

Me Ligjin nr.L06/L-026 për Azil rregullohen kushtet dhe procedurat për njohjen e statusit të refugjatit, mbrojtjes plotësuese, mbrojtjes së përkohshme, statusin, të drejtat dhe detyrimet e azil kërkuesve, persona me status refugjati, si dhe personave tjerë të cilëve i është lejuar mbrojtja plotësuese dhe mbrojtja e përkohshme. Nocioni i refugjatit është përcaktuar sipas konventës së vitit 1951 dhe protokollit të vitit 1967 në lidhje me statusin e refugjatëve. Gjersa, Ligji për Azilin, nr.06/L-026, statusin e refugjatit e përcakton si person i cili për shkak të frikës së mirë të bazuar për të qenë i persekutuar për arsye të racës, religjionit, kombësisë, mendimit politik apo përkatësisë së grupit të caktuar shoqëror është jashtë vendit të shtetësisë dhe nuk ka mundësi apo për shkak të frikës së tillë nuk ka dëshirë të përfitoj mbrojtjen e atij vendi. Apo personin pa shtetësi i cili duke qenë jashtë vendit të banimit të mëparshëm të rregullt, për arsyet e njëjta siç përmendet më lartë nuk ka mundësi apo për shkak të frikës së tillë nuk ka dëshirë të kthehet në atë vend.

Në Republikën e Kosovës, nuk duhet të dëbohet ose kthehet refugjati në asnjë mënyrë në kufijtë e territoreve, ku do të kërcënohet jeta apo liria e azil kërkuesit për arsye të racës, religjionit, përkatësisë kombëtare, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo bindjeve të tij politike. Republika e Kosovës, iu njej të drejtën e azilit shtetasve të huaj apo personit pa shtetësi me kërkesën e tij, i cili plotëson kriteret e refugjatit të përcaktuar me Ligjin për Azilin. Mirëpo, në Republikën e Kosovës, mund të përjashtohet edhe e drejta për azilin ndaj personave të cilët kanë arsye të konsiderohen se: ata persona kanë kryer krime kundër paqes, krime lufte ose krime kundër njerëzimit, personat të cilët kanë kryer krim serioz jo politik jashtë Kosovës, personat të cilët janë fajtor për akte që janë në kundërshtim me qëllimet apo parimet e Kombeve të Bashkuara, siç parashihet në preambule në nenin 1 dhe 2 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Ky ligj ka për qëllim që të harmonizohet me: - Direktivën Nr. 2013/33/EU e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 26 qershor 2013 për Vendosjen e Standardeve të Pranimit të Aplikuesve për Mbrojtje Ndërkombëtare; - Direktivën Nr.2013/32/EU Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 26 qershor 2013 mbi Procedurat e Përbashkëta për Dhënien dhe Tërheqjen e Mbrojtjes Ndërkombëtare; - Direktivën Nr.2001/55/EC e Këshillit e datës 20 korrik 2001 mbi Standardet Minimale për Dhënien e Mbrojtjes Ndërkombëtare në rast të Fluksit Masiv të Personave të Zhvendosur dhe mbi Masat që Promovojnë një Balans të Përpjekjeve të Shteteve Anëtare në Pranimin e Personave të Tillë dhe Bartjen e Pasojave nga kjo; - Direktivën Nr. 2011/95/EU e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 13 dhjetor 2011 mbi Standardet për Kualifikim të Shtetasve të Vendeve të Treta apo Personave pa Shtetësi si Përfitues të Mbrojtjes Ndërkombëtare për një Status Unik për Refugjatët apo për Persona të Përshtatshëm për Mbrojtje Ndërkombëtare si dhe për Përmbajtjen e Mbrojtjes së Dhënë; - Direktiva Nr.2011/51 / BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 majit 2011 për Ndryshimin e Direktivës së Këshillit 2003/109 / EC për Zgjerimin e Fushëveprimit të saj për Përfituesit e Mbrojtjes Ndërkombëtare; -

Direktiva Nr. 2003/86/EC e Këshillit të Bashkimit Evropian e datës 22 shtator 2003 mbi të Drejtën e Ribashkimit Familjar.

## **PROCEDURA E PRANIMIT DHE TRAJTIMIT TË AZILKËRKUESVE**

Personi i cili kërkon të drejtën e azilit duhet të parashtojë kërkesë për azil pranë Policisë së Kosovës, në një pikë të kalimit kufitar, në një Stacion Policor ose në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migrim në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës. Në momentin e paraqitjes së kërkesës për azil, azilkërkuesi pajiset me udhëzuesin për personat të cilët kërkojnë azil në Republikën e Kosovës.

Pas paraqitjes së kërkesës për azil, azilkërkuesi drejtohet pranë Drejtorisë për Migrim në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës, me qëllim të regjistrimit të tij, plotësimit të formularit fillestar të përzgjedhjes për azil. Në rastet kur azilkërkuesi është fëmijë i pashoqëruar, atëherë do të plotësohet formulari i regjistrimit për fëmijë të pashoqëruar. Në momentin e plotësimit të formularit fillestar azilkërkuesi dorëzon të gjitha mjetet e provës dhe dokumentet e identitetit që ka në përdorim.

## **INTERVISTIMI I AZILKËRKUESIT**

Intervista me azilkërkues do të planifikohet të mbahet në një afat të arsyeshëm dhe jo më vonë se tre muaj, që nga data e parashtrimit të kërkesës për azil. Këtë planifikim të marrjes në pyetje të personit i cili ka kërkuar azilin e bënë zyrtari kompetent në kuadër të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim. Derisa të shqyrtohet kërkesa e azilkërkuesit ai vendoset në qendër për azilkërkues të përcaktuar nga DSHAM, ose diku tjetër sipas dëshirës së azilkërkuesit. Në raste të vendosjes së azilkërkuesve në një lokacion sipas zgjedhjes së tij, shpenzimet e akomodimit mbulohen nga vetë azilkërkuesi. Aplikuesi do të intervistohet personalisht pa prezencën e anëtarëve të tjerë të familjes, përveç kur organi kompetent konsideron të domosdoshme prezencën e anëtarëve të tjerë të familjes për një shqyrtim të duhur. Intervistat personale mbi thelbin e aplikacionit për mbrojtje ndërkombëtare në emër të vartësve të tij, çdo vartësi të rritur do t'i jepet mundësia e intervistës personale. DSHAM do ta intervistojë aplikuesin në kohën sa më të shkurtë të mundur. Nëse është e nevojshme, aplikuesi do të intervistohet disa herë.

Aplikuesi është i obliguar të deklaroj të gjitha faktet dhe rrethanat që mbështesin aplikimet e tij/saj për mbrojtje ndërkombëtare, të deklaroj të vërtetën në të gjitha përgjigjet, të paraqes të gjitha provat në dispozicion dhe të jep një shpjegim bindës dhe të besueshëm. Organi kompetent do të marrë masat e duhura për të siguruar se intervistat personale kryhen në kushte të cilat i lejojnë aplikuesit që t'i paraqes arsyet për aplikim në mënyrë gjithëpërfshirëse. Për këtë qëllim,

organi kompetent do të: sigurohet që personi i cili e kryen intervistën është kompetent për t'i marrë parasysh rrethanat personale dhe të përgjithshme lidhur me aplikacionin, duke përfshirë origjinën kulturore të parashtruesit, gjininë, orientimin seksual, identitetin gjinor apo cenueshmërinë; kur është e mundur, të sigurojë që intervista me aplikuesin të kryhet nga një person i gjinisë së njëjtë, nëse aplikuesi e kërkon një gjë të tillë, përveç nëse organi përgjegjës ka arsye të besoj se aplikimi i tillë është i bazuar në arsye të cilat nuk kanë në lidhje vështirësitë e aplikuesit për t'i paraqitur arsyet e aplikimit të tij/saj në mënyrë gjithëpërfshirëse; zgjedhin një përkthyes i cili është në gjendje të sigurojë komunikim të duhur në mes të aplikuesit dhe personit që zhvillon intervistën.

Komunikimi që do të zhvillohet në gjuhën e zgjedhur nga aplikuesi, përveç nëse nuk ka një gjuhë tjetër të cilën ai e kupton dhe në të cilën ai është në gjendje të komunikojë në mënyrë të qartë. Kur është e mundur, organi kompetent siguron një përkthyes të gjinisë së njëjtë nëse aplikuesi e kërkon këtë, përveç nëse organi përgjegjës ka arsye të besojë se aplikimi i tillë është i bazuar në arsye të cilat nuk janë të lidhura me vështirësitë nga ana e aplikuesit për t'i paraqitur arsyet e aplikimit të tij në mënyrë gjithëpërfshirëse; sigurohet që zyrtari i cili kryen intervistën për substancën e aplikacionit për mbrojtje ndërkombëtare nuk ka të veshur uniformë ushtarake, ose të zbatimit të ligjit; sigurohet që intervistat me fëmijët kryhen në mënyrë të përshtatshme për fëmijë; gjatë kryerjes së intervistave personale mbi substancën e aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare, organi përgjegjës sigurohet që aplikuesit t'i jepet mundësi e mjaftueshme për t'i paraqitur elementet e nevojshme për ta mbështetur aplikacionin e tij në përputhje me këtë ligj, në mënyrë sa më të plotë. Kjo përfshinë mundësinë për të dhënë shpjegime në lidhje me elementet që mund të mungojnë dhe/ose mospërputhjet apo kontradiktat në deklaratat e aplikuesit; aplikuesit dhe përfaqësuesit e tyre, apo këshilltarët tjerë, kanë qasje në raport dhe kur është i zbatueshëm regjistrimi para vendimit nga organi kompetent.

Intervista me aplikuesin duhet të mbahet në kushte të cilat garantojnë fshehtësinë . Organi kompetent mund të sigurojë regjistrim ose regjistrim audio vizual të intervistës personale me kusht që ai / ajo të jetë i informuar paraprakisht lidhur me këtë. Duhet të përpilohet raporti faktik për intervistën personale me aplikuesin dhe duhet të nënshkruhet nga aplikuesi për ta konfirmuar vërtetësinë e tij, pasi që t'i komunikohet në gjuhën që ai / ajo e kupton. Kur aplikuesi refuzon të miratojë përmbajtjen e raportit, arsyet për këtë refuzim do të futen në dosjen e aplikuesit. Refuzimi për të miratuar përmbajtjen e raportit nuk do ta ndalojë organin kompetent që të merr vendim në lidhje me aplikacionin Organizimi i intervistës bëhet në atë mënyrë që azil kërkuesit i dërgohet ftesa për intervistë së paku katër ditë para datës së paraparë të zhvillohet intervista. Zyrtari përgjegjës për kërkesën-do ti njoftoj lidhur me intervistën e paraparë, akterët në pajtim me nenin 56 par.2 të Ligjit për Azilin : Pjesëmarrja e palëve të treta në procedurën e azilit :

- Përfaqësuesi i autorizuar,
- Kujdestari ligjor për fëmijët e pa shoqëruar,

- Kujdestari për persona me aftësi të zvogëluar mendore,
- Përfaqësuesi i UNHCR - se,
- Përkthyesi.

Azilkërkuesi nga ana e personit zyrtar DSHAM - së, do të njoftohet lidhur me procedurën e azilit, të drejtat dhe detyrimet në procedurë, parimin e konfidencialitetit, të drejtat dhe detyrimet për të deklaruar faktet, detyrimet për të deklaruar të vërtetën. Gjatë zhvillimit të intervistës përveç tjerave do të përcaktohet: Identiteti i azilkërkuesit dhe të anëtarëve të tjerë të familjes që e shoqërojnë atë, baza e kërkesës së tij për azil, mënyra e hyrjes në Kosovë dhe fakti nëse ai ka parashtruar kërkesën për azil në ndonjë shtet tjetër. Me rastin e intervistimit të azil kërkuesit të njëjti i sigurohet përkthyesi. Pas zhvillimit të intervistës me azilkërkuesin personi zyrtar i DSHAM - së, mund të merr informata edhe nga vendi i origjinës së azilkërkuesit. Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës do të marr vendim të:

- I njeh të drejtën e azilit, azilkërkuesit,
- Refuzon kërkesën për azil dhe njeh mbrojtjen plotësuese,
- Refuzon kërkesën për azil,
- Ndërprenë procedurën e azilit.

**E drejta për status të refugjatit nuk do t'i njihet një personi, për të cilin ka arsye serioze të konsiderohet se ai / ajo:** ka kryer krime kundër pages, krime lufte ose krime kundër njerëzimit siç përcaktohen në instrumentet ndërkombëtare të hartuara për të paraparë dispozita për krime të tilla ; ka kryer krim serioz jo - politik jashtë Republikës së Kosovës para pranimit të tij apo saj si refugjat në Republikën e Kosovës; është fajtor për akte që janë në kundërshtim me qëllimet apo parimet e Kombeve të Bashkuara, siç parashihet në preambulë dhe nenet 1 dhe 2 të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Paragrafi 1. i këtij neni, zbatohet ndaj personave të cilët nxisin apo në mënyrë tjetër marrin pjesë në kryerjen e krimeve ose akteve të lartcekura. Statusi i refugjatit nuk do t'iu lejohet personave të cilët tashmë gëzojnë ndihmën ose mbrojtjen e organeve dhe agjencive të Kombeve të Bashkuara, përveç mbrojtjes ose ndihmës së Komisarariatit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë. Kur një mbrojtje ose ndihmë e tillë ka pushuar për çfarëdo arsye, pa u vendosur definitivisht pozita e këtyre personave në pajtim me rezolutat relevante të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, këta persona në bazë të fakteve (ipso facto) kanë të drejtë të përfitojnë nga ky ligj. Statusi i refugjatit nuk do t'u njihet personave, të cilëve të drejtat dhe detyrimet u janë të njohura nga Republika e Kosovës ngjashëm sikur shtetasve të Republikës së Kosovës. DSHAM - ja, i dorëzon vendimin azilkërkuesit në afatin prej 5 ditësh, që nga data e marrjes së vendimit lidhur me kërkesën. Dorëzimi dhe komunikimi i

vendimit do të bëhet në një gjuhë të cilën azilkërkuesi e kupton. Në rastet kur azilkërkuesi ka përfaqësues të autorizuar, dorëzimi dhe komunikimi i vendimit do t'i bëhet përfaqësuesit të autorizuar. Azilkërkuesi, personi me status refugjati, personi nën mbrojtjen plotësuese apo personi nën mbrojtje të përkohshme ka të drejtë të parashtroj ankesë kundër vendimit të DSHAM - së, pranë Komisionit Kombëtar për Refugjat.

## **DHËNIA E MBROJTJES PLOTËSUESE**

Mbrojtja plotësuese - është mbrojtje që i afrohet shtetasit të huaj apo personit pa shtetësi edhe pse nuk i përmbush kriteret e përcaktimit të statusit të refugjatit, ka arsye serioze dhe të bazuara të mendohet se në rast të kthimit të tij në vendin e origjinës apo të prejardhjes, apo në rastin e personit pa shtetësi në vendin e tij apo të saj të banimit të mëparshëm të rregullt, ai rrezikon realisht të përballet me cenime të rënda dhe nuk ka mundësi apo për shkak të rrezikut të tillë nuk dëshiron të përfitojë nga mbrojtja e atij vendi. Cenime të rënda konsiderohen:

- dënimi me vdekje apo ekzekutimi;
- tortura apo trajtimi ose dënimi çnjerëzor apo degradues i aplikuesit në vendin e origjinës; apo
- kërcënimi serioz dhe individual ndaj jetës së një civili apo personi për shkak të dhunës pa dallim në situata të konfliktit të armatosur ndërkombëtar apo të brendshëm.

Republika e Kosovës ia ofron mbrojtjen plotësuese shtetasit, të huaj apo personit pa shtetësi i cili nuk i përmbush kriteret e përcaktimit të statusit të refugjatit, por i plotëson kriteret e përcaktuara në përkufizimin e mbrojtjes plotësuese të parapara në nenin 3, të Ligjit për Azilin. Sa më parë që është e mundur pasi që statusi i tyre është njohur, Ministria do t'iu lëshojë përfituesve të statusit të mbrojtjes plotësuese një leje banimi e cila duhet të jetë e vlefshme së paku një (1) vit me mundësi vazhdimi, përveç nëse arsyet imponuese të sigurisë shtetërore apo të rendit publik kërkojnë ndryshe.

**Përfashtimi nga mbrojtja plotësuese**-E drejta për mbrojtje plotësuese nuk do t'i njihet personit, për të cilin ka arsye serioze të konsiderohet se:

- ka kryer krime kundër paqes, krime lufte ose krime kundër njerëzimit në kuptim të dispozitave ndërkombëtare që përcaktojnë këto krime;
- ka kryer krime të rënda;



- është fajtor për akte që janë në kundërshtim me qëllimet apo parimet e Kombeve të Bashkuara, siç parashihet në preambulë dhe nenet 1 dhe 2 të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe
- paraqet rrezik për bashkësinë ose për sigurinë e Republikës së Kosovës.

Përjashtimi nga mbrojtja plotësuese zbatohet ndaj personave të cilët nxisin apo në mënyrë tjetër marrin pjesë në kryerjen e krimeve ose akteve të përcaktuara. Mbrojtja plotësuese nuk do t'i jepet një personi i cili ka kryer një apo më tepër vepra penale para se të hyjë në Republikën e Kosovës jashtë fushëveprimtarisë së paragrafit 1. të këtij neni, të cilat vepra penale do të ishin të dënueshme me burgim nëse do të kryheshin në Republikën e Kosovës dhe nëse ai apo ajo e lëshon vendin e tij apo saj të origjinës, vetëm për t'iu shmangur sanksioneve që rezultojnë nga këto krime.

## **ROLI I UNHCR- SË**

Organet shtetërore do ta lejojnë UNHCR - në:

- të ketë qasje tek aplikuesit, duke përfshirë edhe ata nën arrest, në aeroport, kufi dhe në zona transiti;
- të ketë qasje në informata, të aplikacioneve individuale për mbrojtje ndërkombëtare, në zhvillimin e procedurave dhe në vendimet e marra duke siguruar që aplikuesi ka shprehur pajtimin;
- të paraqesë pikëpamjet e veta, si zbatim i përgjegjësive mbikëqyrëse sipas nenit 35 të Konventës së Gjenevës ndaj cilit do organ kompetent, lidhur me aplikacionet individuale për mbrojtje ndërkombëtare në çdo fazë të procedurës.

Lejimet do të zbatohen gjithashtu për organizatën e cila punon në emër të UNHCR-së në territorin e Republikës së Kosovës sipas një marrëveshjeje me Qeverinë e Kosovës.

## **VENDIMI I SHKALLËS SË PARË**

DSHAM-i merr vendim përmes të cilit:

- e njeh statusin e refugjatit;

- refuzon statusin e refugjatit dhe njeh statusin e mbrojtjes plotësuese;
- refuzon aplikacionin për mbrojtje ndërkombëtare;
- ndërprejnë procedurën për përcaktim të statusit të mbrojtjes ndërkombëtare.

DSHAM-i do të marrë vendim në formë të shkruar dhe në rastet kur aplikacioni për mbrojtje ndërkombëtare refuzohet, arsyet faktike dhe ligjore duhet të jenë cekur në vendimin përkatës, si dhe informacionet lidhur me mundësinë e parashtrimit të ankesës.

**Refuzimi i aplikacionit-DSHAM** do të refuzojë aplikacionin në rastet kur:

- aplikuesi nuk i përmbush kriteret e refugjatit siç është përcaktuar në përkufizimin e refugjatit dhe të mbrojtjes plotësuese siç është paraparë në përkufizimin e mbrojtjes plotësuese;
- konsideron se aplikuesi nuk ka të drejtë për mbrojtje sipas neneve 8 dhe 10 të Ligjit për Azilin;
- aplikacioni është i pabazuar sipas nenit 63 të ligjit;
- aplikacioni është i pa pranueshëm sipas nenit 64 të të ligjit.

**Aplikacioni i pabazuar** -DSHAM-i do të refuzojë aplikacionin për mbrojtje ndërkombëtare i cili konsiderohet i pabazuar në procedurë të përshpejtuar në pajtim me garancitë procedurale të përcaktuara në këtë ligj në rastet kur:

- aplikuesi, në momentin e parashtrimit të aplikacionit të tij apo saj dhe fakteve përkatëse, ka ngritur vetëm çështje që nuk janë relevante për shqyrtimin nëse ai ose ajo kualifikohet si përfitues i mbrojtjes ndërkombëtare në pajtim me ligj;
- aplikuesi vjen nga një shtet i sigurt i origjinës, brenda kuptimit të ligjit;
- aplikuesi ka mashtruar organin kompetent duke paraqitur informata apo dokumente të rrejshme, ose duke fshehur informata apo dokumente relevante që vërtetojnë identitetin apo shtetësinë e tij ose saj, në rast se kjo do të kishte ndikim negativ në vendim; ose
- ka gjasa që, me qëllime të këqija, aplikuesi të ketë shkatërruar apo zhdukur dokumentet e identitetit apo udhëtimit të cilat do të ndihmonin në përcaktimin e identitetit apo shtetësisë së tij apo saj; ose
- aplikuesi ka bërë deklarata jokonsistente dhe kundërthënëse, qartas të rrejshme apo dukshëm të paqëndrueshme, të cilat bien ndesh me informatat e vërtetuara që vijnë për

shtetin e origjinës, duke bërë kësisoj pretendime qartë jo të bindshme në lidhje me atë nëse ai ose ajo kualifikohet si përfitues i mbrojtjes ndërkombëtare, në kuptim të ligjit;

- aplikuesi ka paraqitur një aplikim tjetër për mbrojtje ndërkombëtare që nuk është e pranueshme sipas ligjit; ose
- aplikuesi është duke paraqitur aplikacionin vetëm për të vonuar apo penguar një vendim të mëhershëm që do të rezultonte me largimin e tij apo saj; ose
- aplikuesi ka hyrë në territorin e Republikës së Kosovës në mënyrë të paligjshme ose e ka shtyrë qëndrimin në Republikën e Kosovës në mënyrë të paligjshme dhe pa arsye të qëndrueshme, ose nuk është paraqitur para organit kompetent ose nuk ka aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare sa më shpejtë që ka qenë e mundur, marrë parasysh rrethanat e hyrjes së tij apo saj; ose
- aplikuesi refuzon veprimin në pajtim me obligimet për të dhënë shenjat e gishtërinjve sipas ligjit;
- aplikuesi mundet, për arsye serioze, të konsiderohet si rrezik për sigurinë publike ose rendin publik në Republikën e Kosovës, ose aplikuesi është dëbuar me dhunë për arsye serioze për sigurinë publike apo rendin publik, në bazë të legjislacionit kombëtar.

Organi kompetent do ta informojë aplikuesin me kohë për zbatimin e konceptit të vendit të sigurt të origjinës, në mënyrë që t'i mundësohet atij/asaj për të kundërshtuar zbatimin e konceptit të vendit të sigurt të origjinës në kontekst të natyrës dhe rrethanave të tij personale në kuptimin e kualifikimeve të tij/saj për të përfituar mbrojtjen ndërkombëtare sipas këtij ligji. Dispozitat e ligjit nuk do të zbatohen për aplikuesit në pozitë të cenueshme të cilët kanë nevojë për garanci të veçanta procedurale, sidomos viktimat e torturës, përdhunimit ose një formë tjetër e dhunës serioze psikologjike, fizike ose seksuale, në qoftë se garancitë e veçanta/përkrhaja e duhur nuk mund të sigurohet. Aplikacionet e fëmijëve të pashoqëruar mund të shqyrtohen dhe vendimi të bazohet në arsyet e përcaktura.

**Aplikacioni i papranueshëm**-Aplikacioni nuk ka nevojë të shqyrtohet nëse kualifikohet për mbrojtje ndërkombëtare dhe mund të konsiderohet i papranueshëm vetëm nëse:

- shteti anëtar i BE-së i ka ofruar mbrojtje ndërkombëtare;
- shteti që nuk është shtet anëtar i BE-së konsiderohet si shtet i parë i azilit për aplikuesin, sipas këtij ligji;
- shteti që nuk është shtet anëtar i BE-së, konsiderohet shtet i tretë i sigurt për aplikuesin sipas këtij ligji;

- aplikimi është aplikim pasues, ndërsa nuk ka kurrfarë elemente apo gjetje të reja lidhur me shqyrtimin nëse parashtruesi i aplikimit kualifikohet si përfitues i mbrojtjes ndërkombëtare në bazë të këtij ligji të cilat janë shfaqur apo janë paraqitur nga ana e aplikuesit;
- vartësi i aplikuesit paraqet aplikim, pasi që ai apo ajo në pajtim me këtë ligj, të ketë dhënë pëlqimin që rasti i tij apo saj të jetë pjesë e një aplikacion të parashtruar në emrin e tij apo saj, dhe nuk ka fakte që ndërlidhen me situatën e vartësit që justifikojnë një kërkesë të posaçme.

Në rastet kur vendimi është i bazuar vetëm në konceptin e vendit të sigurt të origjinës, organi kompetent do të sigurohet që:

- aplikuesi do të informohet me kohë për zbatimin e konceptit të vendit të tretë të sigurt të origjinës, në mënyrë që të mundësohet atij/asaj për të kundërshtuar zbatimin e konceptit të vendit të tretë të sigurt të origjinës në kontekst të natyrës dhe rrethanave të tij personale;
- organi kompetent do t'i lëshojë aplikuesit të cilit i është refuzuar aplikacioni për mbrojtje ndërkombëtare, një dokument në gjuhën e vendit të tretë të sigurt, sipas të cilit do të informohen autoritetet relevante të vendit përkatës se aplikimi i tij është apo nuk është shqyrtuar në thelb në Republikën e Kosovës;
- në rastet kur vendi i tretë nuk ia lejon aplikuesit hyrjen në territorin e vet, organi kompetent do t'i sigurojë aplikuesit qasje në procedurë në pajtim me parimet bazë dhe garancitë e parapara me këtë ligj.

**Ndërprerja e procedures-DSHAM** do ta ndërpres procedurën për përcaktim të statusit të mbrojtjes në rastet kur plotësohet njëri nga kushtet si në vijim:

- aplikuesi e tërheq aplikacionin për mbrojtje ndërkombëtare;
- kur aplikuesi largohet nga vendqëndrimi i fundit për më shumë se tri (3) ditë pa e njoftuar organin kompetent përveç rasteve kur aplikuesi dëshmon brenda një kohe të arsyeshme se largimi i tij/saj dhe moslajmërimi kanë ndodhur nga rrethanat jashtë kontrollit të tij/saj.

Aplikuesi mund të kërkojë që të rihapet procedura për përcaktim të statusit të mbrojtjes. Kërkesa për ta rihapur procedurën për përcaktim të statusit të mbrojtjes do ta ndalojë dëbimin e aplikuesit nga Republika e Kosovës. Kërkesa për rihapjen e procedurës mund të bëhet vetëm një (1) herë. Aplikuesi ka të drejtë të aplikojë për rihapje të procedurës jo më vonë se nëntë (9) muaj nga koha kur është marrë vendimi i formës së prerë për ndërprerjen e procedurës së përcaktimit të statusit të mbrojtjes.

**Pushimi i statusit të refugjatit-** Shtetasi i huaj apo personi pa shtetësi do të pushoj së qëndruari refugjat, nëse ai apo ajo:

- në mënyrë vullnetare kthehet në mbrojtjen e vendit të shtetësisë; apo
- duke humbur shtetësinë e tij ose saj në mënyrë vullnetare e rikërkon atë; apo
- ka fituar një shtetësi të re dhe gëzon mbrojtjen e vendit të shtetësisë së tij ose saj të re; apo
- në mënyrë vullnetare rivendoset në vendin të cilin ai ose ajo e kishte lëshuar apo jashtë të cilit mbetet me frikën e të qenit i/e persekutuar; apo
- për shkak se rrethanat në lidhje me të cilat ai apo ajo ishte njohur si refugjatë kishin pushuar së ekzistuari, nuk mundet me tutje të vazhdojë të refuzojë që të përfitojë nga mbrojtja e vendit të shtetësisë; apo
- duke qenë person i/e pa shtetësi, për shkak se rrethanat për të cilat ishte njohur si refugjatë kishin pushuar së ekzistuari, ai ose ajo mund të kthehet në vendin e mëparshëm të rregullt.

Me rastin e shqyrtimit, organi kompetent do të ketë parasysh faktin nëse ndryshimi i rrethanave është i natyrës aq të rëndësishme dhe jo të përkohshme, ashtu që frika e refugjatit për persekutim nuk mund të konsiderohet më tutje si e mirë bazuar andaj, do të aplikohet për refugjatin i cili mund të parashtrijë arsye bindëse që dalin nga persekutimi i mëparshëm për refuzimin e përfitimit e tij apo saj nga mbrojtja e vendit të shtetësisë, apo duke qenë person pa shtetësi, të vendbanimit të mëparshëm

**Afatet e procedurës në shkallën e parë-**Procedura për përcaktim të statusit të mbrojtjes në shkallë të parë si rregull zgjatë gjashtë (6) muaj që nga dita e parashtrimit të aplikacionit. Afati prej (6) muajve mund të zgjatet për një periudhë shtesë prej tre (3) muajve, por jo më gjatë se nëntë muaj (9) në rastet kur:

- kemi të bëjmë me çështje komplekse, faktike ose ligjore;
- një numër i madh i shtetasve të huaj apo personave pa shtetësi kanë aplikuar përnjëherë për mbrojtje ndërkombëtare, duke e bërë të vështirë në praktikë përfundimin e procedurës brenda afatit gjashtëmuajor (6);
- kur vonesat nuk mund t'i atribuohen qartë dështimit të aplikuesit për të vepruar në pajtueshmëri me obligimet e tij ose saj sipas ligjit.

Si përjashtim, organi kompetent në rrethana të justifikueshme, nuk do të tejkalojë afatet e përcaktuara në këtë paragraf për më shumë se tre (3) muaj, kurdo që kjo është e nevojshme për të siguruar shqyrtim adekuat dhe të plotë të aplikacionit. Organi kompetent mund të shtyjë përfundimin e procedurave të shqyrtimit në rastet kur nga organi kompetent nuk mund të pritët me arsye që të vendosë brenda afateve të përcaktuara për arsye të situatës së paqartë në shtetin e origjinës e cila pritët të jetë e përkohshme. Në rast të tillë, organi kompetent do të:

- shqyrtojë situatën në shtetin e origjinës së paku çdo gjashtë (6) muaj;
- informojë aplikuesin së paku çdo gjashtë (6) muaj për arsyet e shtyrjes dhe afatet kohore brenda së cilave pritët të nxirret vendimi për kërkesën e tij apo saj;

Në çdo rast, organi kompetent do të kryejë procedurën e shqyrtimit brenda afatit maksimal kohor prej njëzet e një (21) muaj nga aplikimi. Vendimet në mbështetje në ligj, duhet si rregull i përgjithshëm të merren brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës.

## **PROCEDURA E ANKESËS PRANË KOMISIONIT KOMBËTAR PËR REFUGJATË**

Azil kërkuesi i pa kënaqur me vendimin e nxjerr nga DSHAM-ja, mund të ushtroj ankesë pranë Komisionit Kombëtar për Refugjatë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e njoftimit të vendimit përveç në rastet të përcaktuara ndryshe me këtë ligj. Ankesa dorëzohet dhe nënshkruhet nga pala ankuese në ndonjërin nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. Ankesës duhet t'i bashkëngjitet dokumentacioni mbështetës. Në ankesë duhet të ceket numri dhe data e vendimit të cilit i referohet. Ankesa drejtuar komisionit duhet të dorëzohet nëpërmjet sekretarisë. Pas pranimit të ankesës, komisioni së pari vërteton nëse ajo është bërë brenda afatit të përcaktuar me nenin 74 të Ligjit për Azil dhe nëse ajo është bërë nga personi i autorizuar. Ankesa e bërë jashtë afatit të lejuar dhe nga personi i pa autorizuar hedhet poshtë me vendim nga komisioni. Pala ankuese duhet të paraqes fakte dhe argumente ligjore që nuk janë shqyrtuar më parë nga organi i shkallës së parë ose të pohojë se organi i shkallës së parë ka bërë shkelje faktike, ligjore ose procedurale gjatë marrjes së vendimit. Ankesa duhet që ti specifikojë shkaqet dhe arsyet për ankimimin e aktvendimit të shkallës së parë dhe ato si në vijim:

- Shkelje e dispozitave të drejtës procedurale,
- Konstatim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike,
- Shkelje e dispozitave të drejtës materiale,
- Fakte të reja të rëndësishme në mbështetje të kërkesës.

Pala ankuese në ankesë, duhet gjithashtu të parashtroj propozim konkret lidhur me çështjen që është objekt shqyrtimi. Sekretaria do t'i dorëzoj komisionit kopje të dokumenteve jo më vonë se 3 ditë, para seancës në të cilën do të shqyrtohet ankesa, dosjes duhet ti bashkëngjiten:

- Vendimi ndaj të cilit parashtrohet ankesa,
- Ankesën së bashku me dokumentacion mbështetës ( dosjen e lëndës ).

Barra e paraqitjes së provës mbi të cilat mbështet ankesa bie mbi vetë palën e cila ka ushtruar ankesë. Komisioni nëpërmjet sekretarisë i njofton palët me shkrim për kohën , datën dhe vendin ku do të mbahet seanca më së paku tre ditë para të mbahet seanca . Seanca para komisionit është e tipit të mbyllur. Komisioni vendos për lejimin e pjesëmarrjes së personave të tjerë në seancë pas konsultimit me palët në procedurë. Seanca shqyrtuese do të mbahet në ndonjërin nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës . Palët në seancë janë parashtruesi i ankesës dhe komisioni. Në seancë për shqyrtimin e ankesës merr pjesë përfaqësuesi i UNHCR - it, në cilësinë e vëzhguesit. Kryetari i komisionit e udhëheqë seancën, komisioni mund të kërkoj prova shtesë lidhur me çfarëdo çështje që parashtrohet nga cilado palë gjatë procedurës. Komisioni merr vendim me shumicë të votave. Vendimi i komisionit duhet të jetë i përpiluar me shkrim, i arsyetuar dhe i nënshkruar nga kryetari i komisionit. Komisioni me vendimin e tij mund të:

- Miratoj vendimin e shkallës së par,
- Anuloj vendimin e shkallës së parë dhe të njëjtin e kthen për rishqyrtim,
- Të bëjë ndryshimin e vendimit të shkallës së parë mbi bazën e të njëjtave prova.

Komisioni do ta shqyrton ankesën në afat prej 30 ditësh, nga dita kur është parashtruar ankesa, përveç rasteve të ankesave të paraqitura kundër vendimeve të marra konform nenit 63 të Ligjit për Azil kur kërkesa për azil është e pabazuar, komisioni duhet të vendos në afat prej 15 ditësh, nga dita e parashtrimit të ankesës. Vendimi bëhet i plotfuqishëm në ditën kur i dorëzohet parashtruesit të ankesës. Vendimi i komisionit është vendim përfundimtar në procedurë administrative dhe se i njëjti mund t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën Themelore, Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë.

Komisioni Kombëtar për Refugjatë përbëhet pre : Kryetarit të komisionit, Zëvendës kryetarit si dhe 5 anëtarëve të tjerë. Komisioni vendosë në mënyrë meritore në përbërje prej 3 anëtarëve, mirëpo në kryesi të këtij komisioni duhet të jetë Kryetari apo Zëvendës kryetari i Komisionit Kombëtar për Refugjatë. Ankesa e ushtruar kundër vendimit të shkallës së parë dhe të dytë e pezullon apo e shtyn ekzekutimin e vendimit konform nenit 73, paragrafi 3 të Ligjit për Azilin .

## **TË DREJTAT DHE DETYRIMET E APLIKUESVE, PERSONAVE ME STATUS REFUGJATI DHE PERSONAVE NËN MBROJTJE PLOTËSUESE**

**Aplikuesi ka të drejtë:** të qëndrojë në Republikën e Kosovës; të ketë kushtet themelore të jetesës; të ketë kujdesin shëndetësor; të ketë ndihmën sociale themelore; të ketë ndihmën ligjore pa pagesë në arsimim për aplikuesit fëmijë; në lirinë e mendimit dhe besimit fetar; për punësim dhe të drejtën në trajnime profesionale.

**Aplikuesi është i detyruar:** gjatë gjithë kohës të veprojë në pajtim me legjislacionin përkatës të Republikës së Kosovës, si dhe me masat e ndërmarra nga organet shtetërore; të bashkëpunojë me DSHAM - në dhe organet e tjera relevante qeveritare; t'i përgjigjet ftesave të organit kompetent dhe zyrave të tjera qeveritare dhe të bashkëpunojë në çdo fazë të procedurës së azilit; të dorëzojë dokumentet e udhëtimit, identitetit dhe prova të tjera që i ka në dispozicion; të njoftojë DSHAM - in dhe organet e tjera përkatëse të mbrojtjes ndërkombëtare për çfarëdo ndryshimi të adresës brenda tri ( 3 ) ditësh; të veprojë në pajtim me urdhrat që lëshohen nga organi kompetent dhe të gjitha urdhrat e tjera qeveritare lidhur me kufizimet e lëvizjes; të mos lëshojë territorin e Republikës së Kosovës pa lejen e organit kompetent derisa të mos përfundohet procedura e azilit; të bashkëpunojë me organin kompetent lidhur me marrjen e gjurmëve të gishtërinjve dhe fotografisë; organi kompetent mund të kontrollojë aplikuesin dhe gjësendet të cilat ai i ka. Pa paragjykuar kontrollet e kryera për arsye sigurie, kontrollet e aplikuesit në kuadër të këtij ligji, duhet të kryhen nga persona të gjinisë së njëjtë me respekt të plotë ndaj parimeve të dinjitetit njerëzor dhe integritetit fizik dhe psikologjik; organi kompetent mund ta fotografojë aplikuesin. Organi kompetent mund të mbajë procesverbal lidhur me deklaratimet e aplikuesit, nëse paraprakisht ai është informuar për këtë.

## **KORNIZA LIGJORE NDËRKOMBËTARE PËR MBROJTJEN E REFUGJATËVE**

Shtetet janë të detyruara të mbrojnë të drejtat e qytetarëve të tyre. Kur qeveritë nuk janë në gjendje ose nuk dëshirojnë ta bëjnë këtë, njerëzit mund të përballen me një kërcënim kaq serioz sa që do të detyrohen të largohen nga vendi i tyre dhe të kërkojnë siguri diku tjetër. Nëse kjo ndodh, një vend tjetër duhet të merr përgjegjësi dhe të sigurojë që të drejtat themelore të refugjatëve të respektohen. Kjo njihet si “mbrojtje ndërkombëtare”. Konventa e Statusit të Refugjatëve e vitit 1951 dhe Protokollin për të i vitit 1967 janë baza e sistemit të mbrojtjes ndërkombëtare, të plotësuara me marrëveshje dhe deklarata rajonale, të cilat gjithashtu i referohen të drejtave të refugjatëve. Por ligji ndërkombëtar i refugjatëve nuk funksionon në mënyrë të izoluar. Kjo kuptohet më së miri në lidhje me ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, duke filluar me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të vitit 1948 dhe e drejta ndërkombëtare humanitare (ligji i luftës). Kjo kornizë më e gjerë ligjore ndërkombëtare është



baza për punën e Komisarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR). Asambleja e Përgjithshme e OKB-së e themeloi UNHCR-në pas Luftës së Dytë Botërore për të garantuar mbrojtjen ndërkombëtare të refugjatëve dhe për të punuar me qeveritë për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme për problemet e refugjatëve. Ky kapitull paraqet kornizën ligjore ndërkombëtare për mbrojtjen e refugjatëve, përkatësisht: • Instrumentet themelore të së drejtës ndërkombëtare të refugjatëve: Konventa e vitit 1951 dhe Protokoli i vitit 1967 për të;

- Aktet ligjore dhe standardet rajonale për refugjatët nga Afrika, Amerika Latine dhe Evropa;

- Standarde të tjera përkatëse të përfshira në ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe të drejtën penale ndërkombëtare; dhe

- burime të tjera të ligjit dhe udhëzime.

E drejta dhe standardet ndërkombëtare për refugjatët Konventa e Statusit të Refugjatëve e vitit 1951 Konventa e Statusit të Refugjatëve e vitit 1951 është baza e ligjit ndërkombëtar për refugjatët. Ai përcakton termin “refugjat” (shih më poshtë: Kush është refugjat sipas Konventës së vitit 1951?), e përcakton parimin që refugjatët nuk duhet të kthehen me forcë në një territor ku ekziston një kërcënim për jetën ose lirinë e tyre. (shih më poshtë: Parimi i moskthimit) dhe përcakton detyrimet e refugjatëve dhe detyrimet e Shteteve ndaj tyre. Konventa u hartua menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore dhe autorët e saj u përqëndruan në çështjet aktuale të refugjatëve. Përkufizimi i një refugjati që përmbahet në Konventën e vitit 1951 u referohet personave që u bënë refugjatë si rezultat i ngjarjeve para 1 janarit 1951 dhe Shtetet duhet të deklaronin nëse ata do të zbatonin përkufizimin vetëm për ngjarjet në Evropë ose për ngjarjet në pjesë të tjera të botës. Me shfaqjen e krizave të reja të refugjatëve në botë në vitet 1950-ta dhe fillimin e viteve 1960-ta, u bë e qartë se fusha kohore dhe hapësinore e Konventës së vitit 1951 duhet të zgjerohet. Për këtë qëllim, u miratua Protokoli për Konventën në vitin 1967. Protokoli i vitit 1967 Protokoli i vitit 1967 është një dokument i veçantë nga Konventa e vitit 1951, por në thelb lidhet me të. Protokoli heq kufizimet kohore dhe gjeografike të Konventës. Duke iu aderuar Protokolit, Shtetet morën përsipër të zbatonin substancën thelbësore të Konventës së vitit 1951 (Nenet 2–34) për të gjithë personat e mbuluar nga përkufizimi i refugjatit në Protokol, pa kufizim kohor dhe hapësinor.

Shumica e Shteteve preferojnë t’i bashkohen Konventës dhe Protokolit. Ata konfirmojnë kështu që të dy marrëveshjet janë elemente qendrore të sistemit ndërkombëtar të mbrojtjes së refugjatëve. Konventa e vitit 1951 dhe Protokoli i vitit 1967 janë mishërimi modern i azilit si një institucion antik. Forca e tyre qëndron në karakterin e tyre universal dhe jodiskriminues dhe në vlerat thelbësore që ato reflektojnë. “Ne rikonfirmojmë Konventën e Kombeve të Bashkuara të vitit 1951 në lidhje me statusin e refugjatëve. dhe Protokoli i vitit 1967 si themeli i regjimit ndërkombëtar të mbrojtjes së refugjatëve. Ne e njohim rëndësinë e zbatimit të tyre të plotë dhe

efektiv nga Shtetet dhe vlerat që ato mishërojnë. (...) Ne rikonfirmojmë respektin për institucionin e azilit dhe të drejtën për të kërkuar azil. Ne gjithashtu, rikonfirmojmë respektimin tonë dhe përkushtimin ndaj parimit themelor të moskthimit në përputhje me ligjin ndërkombëtar të refugjatëve.”

Konventa e vitit 1951 dhe Protokollin e vitit 1967: Konventa e vitit 1951 dhe Protokollin e vitit 1967 mbulojnë tre tema kryesore:

- përkufizimi i një refugjati, së bashku me dispozitat për përfundimin e statusit ose përjashtimin nga statusi i refugjatit;
- statusi ligjor (të drejtat dhe detyrimet) e refugjatëve në vendin e azilit. Kjo përfshin detyrën e refugjatëve për të respektuar ligjet dhe rregulloret e vendit të azilit dhe të drejtat e tyre në vend, duke përfshirë mbrojtjen nga kthimi; dhe
- detyrimet e Shteteve, përfshirë detyrimin për të bashkëpunuar me UNHCR-në në kryerjen e punëve të Organizatës dhe për t'i mundësuar asaj të kryejë detyrën e saj për të mbikëqyrur zbatimin e Konventës. Kush është refugjat sipas Konventës së vitit 1951? Sipas Konventës së vitit 1951 Refugjat është personi i cili:
  - me të drejtë i frikësohet persekutimit për shkak të: racës, fesë, kombësisë, përkatësisë në një grup të caktuar shoqëror ose besimit politik;
  - ndodhet jashtë vendit të tyre të origjinës ose vendbanimit të zakonshëm;
  - nuk mundet ose nuk dëshiron të përdorë mbrojtjen e atij vendi ose të kthehet atje nga frika e persekutimit; dhe
  - nuk është përjashtuar në mënyrë të qartë nga mbrojtja si refugjat ose statusi i tij / saj i refugjatit nuk ka pushuar për shkak të ndryshimit të rrethanave.

Personi është një refugjat posa që të plotësohen kriteret e përcaktuara në përkufizim. Me fjalë të tjera, personi nuk bëhet refugjat për shkak të një vendimi pozitiv mbi një kërkesë për mbrojtje. Njohja e statusit të refugjatit është një akt deklarativ: me këtë konfirmohet që personi është me të vërtetë refugjat. Përderisa kjo mund të duket si një çështje teknike, kjo është arsyeja pse azilkërkuesit nuk duhet të kthehen në vendin e tyre të prejardhjes derisa të merret parasysh kërkesa e tyre.

## **PARIMI I MOSKTHIMIT SIPAS KONVENTËS SË VITIT 1951**

E drejta e refugjatit për tu mbrojtur nga kthimi i detyruar është themeli i mbrojtjes ndërkombëtare të refugjatit. Ai përmbahet në nenin 33 (pika 1) të Konventës së 1951, i cili thotë: “Asnjëra nga Palët Kontraktuese nuk do të dëbojë ose riatdhesojë një refugjat në asnjë mënyrë deri te kufijtë e territoreve ku jeta ose liria e tij kërcënohet nga raca, feja, kombësia e tij, përkatësia e tij te një grup konkret shoqëror ose bindjet politike”. Fjalët “në çdo mënyrë” nënkuptojnë që parimi i moskthimit zbatohet për çdo veprim të ndërmarrë nga Shteti, i cili do ta vënte refugjatin në rrezik të kthimit, qoftë direkt apo indirekt, në vendin e prejardhjes. Kjo përfshin moslejimin e hyrjes në kufi dhe largimin nga brendësia e territorit. Parimi i moskthimit zbatohet kudo që Shteti ushtron kompetencat e tij, përfshirë përtej kufijve të tij, për shembull kur bastis anijet në ujërat ndërkombëtare. Të gjithë refugjatët kanë të drejtë në mbrojtje nga kthimi, përfshirë ata që nuk janë njohur zyrtarisht si refugjatë. Kjo do të thotë që azilkërkuesit, statusi i të cilave ende nuk është përcaktuar nga autoritetet mbrohen nga kthimi i detyruar.

### **Deklarata e Kartagjenës e vitit 1984**

Në vitin 1984 Një takim i zyrtarëve të qeverisë dhe avokatëve të shquar u thirr në Kartagjenë, Kolumbi për të diskutuar mbrojtjen e refugjatëve në Amerikën Latine. Të inspiruar nga Konventa e vitit 1969 e OAU-së, pjesëmarrësit miratuan të ashtuquajturën Deklarata e Kartagjenës për refugjatët. Deklarata rikonfirmon vendin qendror të Konventës së vitit 1951 dhe Protokolit të vitit 1967, parimi i moskthimit dhe rëndësia e bashkëpunimit ndërkombëtar në zgjidhjen e çështjeve të refugjatëve. Ajo rekomandon që përkufizimi i refugjatit i përdorur në rajon të shtrihet për të përfshirë jo vetëm personat që plotësojnë përkufizimin e Konventës së vitit 1951, por edhe njerëz që ikin nga vendet e tyre “sepse jeta, siguria ose liria e tyre kërcënohen nga dhuna e përgjithshme, agresioni i huaj, konfliktet e brendshme, shkeljet masive të të drejtave të njeriut ose rrethana të tjera që prishin seriozisht rendin publik”. (Shih më lart: Kush është një refugjat sipas Konventës së OAU-së të vitit 1969 dhe sipas Deklaratës së Kartagjenës?)

Edhe pse Deklarata nuk është një instrument ligjërish i detyrueshëm, shumica e vendeve të Amerikës Qendrore dhe Jugore zbatojnë përkufizimin, dhe shumë prej tyre e kanë përfshirë atë në ligjin kombëtar. Organizata e Shteteve Amerikane (OAS), Asambleja e Përgjithshme e OKB-së dhe Komiteti Ekzekutiv i UNHCR-së mbështetën Deklaratën e Kartagjenës. Që nga viti 1984 Vendet e Amerikës Qendrore dhe Jugore miratuan tre deklarata me rastin e përvjetorëve të rëndësishëm të Deklaratës së Kartagjenës, përfshirë deklaratën më të fundit, Deklaratën Braziliene dhe Planin e Veprimit 2014.

### **Bashkimi Evropian (EU)**

Bashkimi Evropian, ka krijuar një sistem të vetëm evropian të azilit bazuar në “Zbatimin e plotë dhe gjithëpërfshirës të Konventës së Gjenevës”. Versionet fillestare dhe të rishikuara të katër

instrumenteve kryesorë legjislativë janë miratuar që atëherë. Secili prej këtyre akteve shton përmbajtje në ligjin për refugjatët në zonat që nuk mbulohen nga Konventa e vitit 1951. Këto instrumente kanë të bëjnë me: (a) mbrojtjen e përkohshme; (b) pritjen e azilkërkuesve; (c) pranueshmërinë për statusin e refugjatit ose ‘mbrojtjen plotësuese’ dhe të drejtat dhe statusin për të cilin kanë të drejtë përfituesit; dhe (d) standardet për procedurat e azilit. Për më tepër, Rregullorja e Dublinit III përcakton kriteret për përcaktimin se cili Shtet Anëtar i BE-së ose ndonjë vend tjetër pjesëmarrës ka juridiksion mbi një kërkesë azili. Dy agjenci të BE-së janë ngritur për të siguruar mbështetje operationale: Agjencia Evropiane e Kufijve të Jashtëm Frontex në vitin 2005 dhe Zyra Evropiane për Mbështetjen e Azilit (EASO) në vitin 2010. Karta e të Drejtave Themelore, e miratuar në vitin 2007, ka një status të barabartë me traktatet themeluese të BE-së. Ai përfshin dispozita për të drejtën e azilit dhe mbrojtjen kundër largimit, dëbimit ose ekstradimit, duke u ekspozuar ndaj një rreziku serioz të dënimit me vdekje, torturës ose trajtimit ose dënimit tjetër çnjerëzor ose degradues. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (CJEU) ka juridiksion për të interpretuar këto instrumente të azilit të BE-së dhe për të vendosur mbi shkeljet e pretenduara nga vendet anëtare. Së bashku me Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës, e cila vendos për çështjet e azilit në kontekstin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, kjo gjykatë ka një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin më të gjerë të ligjit ndërkombëtar të refugjatëve.

### **Ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut**

Si të gjithë njerëzit e tjerë, azilkërkuesit dhe refugjatët mbrohen nga ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Kjo fushë e ligjit zbatohet për të gjithë personat e vendosur në territorin e një Shteti të caktuar ose nën juridiksionin e tij. Siç pohohet në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të vitit 1948, “të gjitha qeniet njerëzore lindin të lira dhe të barabarta në dinjitet dhe të drejta”. Prandaj, azilkërkuesit dhe refugjatët gëzojnë dy kategori të drejtash, të cilat pjesërisht kërkojnë: ato që shtetet janë të detyruara të respektojnë, mbrojnë dhe përmbushin sipas ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe të drejtat specifike të refugjatëve. (Për më shumë informacion mbi punën e organeve të UOKB-së për monitorimin e të drejtave të njeriut për mbrojtjen e azilkërkuesve dhe refugjatëve, shih Kapitullin 8.) Sipas ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, disa masa mbrojtëse, të tilla si ndalimi i torturës dhe skllavërisë, nuk mund të kufizohen ose pezullohen për asnjë arsye. Disa të drejta të tjera mund të përjashtohen nga kushte të caktuara, për shembull për të ruajtur rendin publik ose shëndetin publik, ose për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve. Derogimi nuk duhet të jetë diskriminues, ai duhet të deklarohet zyrtarisht dhe në përputhje me ligjin. Konventa kundër Torturës dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijëve janë instrumente të të drejtave të njeriut që ofrojnë mbrojtje të rëndësishme për azilkërkuesit dhe refugjatët. Traktate të tjera të të drejtave të njeriut gjithashtu plotësojnë ligjin ndërkombëtar të refugjatëve në mënyra të rëndësishme, siç përshkruhet më poshtë.

## **BURIME TË TJERA TË LIGJIT DHE UDHËZIME REZOLUTAT DHE DEKLARATAT E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË OKB-SË**

Çdo vit, Asambleja e Përgjithshme shqyrton raportin mbi punën e UNHCR-së dhe miraton një rezolutë mbi këtë temë. Parlamenti ka miratuar gjithashtu një numër rezolutash mbi aspektet specifike të mbrojtjes së refugjatëve, të tilla si ato për refugjatët e mitur të pashoqëruar, të drejtat e njeriut dhe eksodet masive, dhe situatën në vendet specifike që marrin flukse të mëdha refugjatësh. Në shtator të vitit 2016 Asambleja e Përgjithshme miratoi Deklaratën e Nju Jorkut mbi Refugjatët dhe Migrantët dhe nisi negociatat ndërqeveritare për të arritur një “konsensus global për migracionin e sigurt, të rregullt dhe të ligjshëm”. Ashtu si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e miratuar në 1948, Deklarata e Nju Jorkut është një dokument politik. Ajo i vendos refugjatët në qendër të vëmendjes politike dhe inkurajon një qasje të gjerë për mbrojtjen e refugjatëve, me përfshirjen e gjithë shoqërisë.

### **INICIMI I KONFLIKTIT ADMINISTRATIV PËR TË DREJTËN E AZILIT**

Konflikti administrativ lind si rrjedhojë e marrëdhënieve juridike administrative në rastin kur me aktin administrativ përfundimtar ( vendimi ) i Komisionit Kombëtar për Refugjatë, është shkelur e drejta e azilkërkuesit.

Me aktin administrativ përfundimtar pala e pakënaqur kundër vendimit përfundimtar të Komisionit Kombëtar për Refugjatë, kur nuk mund të përdor mjete të rregullta juridike atëherë lind konflikti midis palës dhe organit të cilin e ka nxjerr aktin administrativ përfundimtar. Ky konflikt lind si rrjedhojë e ligjshmërisë së aktit përfundimtar me të cilin organi shtetëror vendos mbi të drejtën, detyrimin ose interesin juridik të azilkërkuesit. Procedura e Konfliktit Administrativ është e rregulluar me ligjin nr. 03 / L 202 i miratuar nga Parlamenti i Kosovës me dt. 17 shtator 2010. Me këtë ligj rregullohen kompetenca, përbërja e gjykatës dhe rregullat e procedurës, në bazë të të cilave gjykatat kompetente vendosin për ligjshmërinë e akteve administrative me të cilat organet kompetente të administratës publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizik dhe juridik dhe të palëve tjera, si dhe për ligjshmërinë e veprimeve të organeve administrative .

Qëllimi i këtij Ligji për Konfliktet Administrative është sigurimi i mbrojtjes gjyqësore të të drejtave dhe interesave juridike të personave fizik, juridik dhe palëve të tjera të cilat të drejta dhe interesa janë cenuar me vendime individuale ose me veprime të organeve të administratës publike. Parimet themelore të Ligjit për Konflikte Administrative janë: Parimi i ligjshmërisë për çka gjykata është kompetente të vendos në bazë të kushtetutës dhe ligjeve. Parimi i deklarimit të palës Para nxjerrjes së aktgjykimit gjykata është e obliguar që ti jap mundësinë e deklarimit secilës palë, mbi të gjitha kërkesat dhe pretendimet e palëve të tjera dhe mbi të gjitha faktet dhe çështjet juridike që janë objekt i shqyrtimit në konfliktin administrativ. Gjykata mund të vendos

lidhur me çështjen e konfliktit administrativ pa dhënien e mundësisë palës për tu deklaruar, vetëm në ato raste kur ligji e ka paraparë një gjë të tillë.

Parimi i shqyrtimit verbal në procedurën gjatë shqyrtimit të kërkesës lidhur me konfliktin administrativ gjykata vendos në bazë të shqyrtimit verbal të drejtpërdrejt dhe publik. Që do të thotë se gjykata duhet të vendos në formë transparente gjatë gjithë procedurës përveç në ato raste kur ligji e ka paraparë që të vendos me seancë të mbyllur. Parimi i efikasitetit gjykata me rastin e inicimit të konfliktit administrativ nga ana e palës është e obliguar që sa më shpejtë dhe pa zvarritje ta zhvillojë procedurën e konfliktit administrativ duke iu shmangur veprimeve dhe shpenzimeve të panevojshme, me çka e pamundëson keqpërdorimin dhe zvarritjen e realizimit të drejtave të palëve, të pjesëmarrësve të tjerë në konflikt administrativ duke e nxjerr në afat të parashikuar vendimin. Parimi i ndihmës së palës së painformuar, gjykata gjatë procedurës lidhur me konfliktin administrativ kujdeset që mos informimi i palës dhe pjesëmarrësve të tjerë në konflikt administrativ, të mos jetë në dëm të drejtave të cilat i kanë në bazë të ligjit.

## **OBJEKTI I KONFLIKTIT ADMINISTRATIV - AKTI ADMINISTRATIV**

Në bazë të ligjit për konfliktin administrativ, konflikti administrativ mund të iniciohet vetëm kundër aktit administrativ të nxjerr në procedurën administrative në shkallë të dytë që në rastin konkret është vendimi i Komisionit Kombëtar për Refugjatë si vendim përfundimtar në procedurë administrative.

## **SHKAQET PËR TË CILAT AKTI ADMINISTRATIV MUND TË KUNDËRSHTOHET**

Akti administrativ përkatësisht vendimi i Komisionit Kombëtar për Refugjat, mund të kundërshtohet për dy shkaqe dhe atë: Për shkaqet formale juridike dhe shkaqet materiale juridike:

### **Shkaqet formale juridike për të cilat mund të kundërshtohet akti administrativ janë:**

1. Nëse akti administrativ është nxjerr nga organi jo kompetent,
2. Për shkak se në procedurën që i ka paraprirë nxjerrjes së aktit nuk është vepruar sipas dispozitave të procedurës,
3. Për shkak se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe
4. Për shkak se nga faktet e vërtetuara është nxjerrë përfundimi i gabuar, jo i drejtë përkitazi me gjendjen faktike.

### **Shkaqet materiale juridike për të cilat mund të kundërshtohet akti administrativ janë:**

1. Me rastin e nxjerrjes së aktit administrativ nuk është aplikuar fare ose nuk është aplikuar drejt ligji, dispozita e bazuar në ligj.
2. Me rastin e nxjerrjes së aktit administrativ, organi për realizimin e qëllimit tjetër e jo për qëllimin i cili buron nga ligji.

## **PALËT NË KONFLIKT ADMINISTRATIV**

Ligji për Konflikt Administrativ ka përcaktuar saktë se kush mund të jetë palë në konflikt administrativ, ashtu që palë në konflikt administrativ janë:

1. Padiësi,
2. I padituri dhe
3. Personi i interesuar.

Padiësi në konflikt administrativ është personi fizik, juridik, avokati i popullit, shoqatat dhe organizatat tjera që janë të legjitimuara për ngritjen e padiës me të cilën goditet ligjshmëria e aktit administrativ i nxjerrë nga organi administrativ. Padiës në konfliktin administrativ mund të jetë subjekti që ka legjitimitet për iniciimin e konfliktit administrativ. Pra konfliktin administrativ mund ta iniciojnë vetëm personat e autorizuar me ligj për iniciimin e konfliktit administrativ. Padiës në konfliktin administrativ mund të jetë personi të cilit i është shkelur ndonjë e drejtë ose interes juridik me aktin administrativ të organit shtetëror.

## **PALA E PADITUR NË KONFLIKT ADMINISTRATIV**

Pala e paditur në konflikt administrativ është organi shtetëror, përkatësisht organizata që ushtron autorizime publike, në rastin konkret është Komisioni Kombëtar për Refugjat. Meqenëse konflikti administrativ iniciohet kundër aktit administrativ përfundimtar, pala e paditur është organi i cili ka nxjerr aktin administrativ i cili akt është akt përfundimtar në procedurën administrative. Akt administrativ përfundimtar sipas Ligjit të Procedurës Administrative është ai akt që është nxjerrë në shkallë të dytë dhe se kundër këtij akti administrativ nuk lejohet mjet i rregullt juridik-ankesa. Konflikti administrativ mund të iniciohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë. Mirëpo kundër këtij akti administrativ nuk është i lejuar mjeti juridik-ankesa. Konflikti administrativ mund të iniciohet edhe me rastin e heshtjes administrative. Që do të thotë se pas përfundimit të afateve ligjore të heshtjes administrative, pala mund të inicioj konflikt administrativ për shkak të heshtjes së administratës.

## **KOMPETENCA E GJYKATËS**

Konflikti administrativ si procedurë e veçantë gjyqësore mund të iniciohet pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, këtë kompetencë e ka përcaktuar ligji për gjykatat nr. 03 / L - 199, i miratuar nga Parlamenti i Kosovës. Neni 14 i këtij ligji ka përcaktuar se Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështje tjera të përcaktuara me ligj. Të gjitha çështjet në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore gjykohen nga një gjyqtar profesionist, përpos nëse me ligj nuk parashihet ndryshe. Kundër aktgjykimeve të Gjykatës Themelore - Departamenti për Çështje Administrative, mund të ushtrohet ankesë dhe se lidhur me ankesën kompetent për me vendosë është Gjykata e Apelit, gjersa me mjete të jashtëzakonshme vendosë Gjykata Supreme e Kosovës si gjykatë e instancës më të lartë gjyqësore në Kosovë.

## **PADIA NË KONFLIKTIN ADMINISTRATIV**

Në bazë të Ligjit për Konfliktin Administrativ, procedura iniciohet me padi duke atakuar ligjshmërinë e aktit administrativ. Kjo procedurë iniciohet sipas parimit të dispozicionit të palës e jo sipas parimit officialitetit që do të thotë se padinë e paraqet paditësi për shkak se i njëjti konsideron se me aktin administrativ i është mohuar ndonjë e drejtë apo detyrim. Pa padi nuk ka konflikt administrativ. Në kuptimin formal padia është parashtrësë e hartuar në mënyrë të rregullt, e drejtuar me kohë gjykatës nga ana e personit të legjitimuar për inicimin e konfliktit administrativ duke e atakuar aktin administrativ. Konflikti administrativ mund të iniciohet dhe të zhvillohet vetëm kundër aktit administrativ të përfunduar, do të thotë se konflikti administrativ mund të fillohet, kundër akteve administrative të nxjerra në shkallë të dytë sepse këto akte administrative janë përfundimtare në procedurën administrative. Mirëpo konflikti administrativ mund të iniciohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër këtij akti administrativ në procedurë administrative ankesa nuk është e lejuar. Konflikti administrativ mund të iniciohet edhe me rastin e heshtjes administrative, që do të thotë se palës të cilit organi administrativ nuk i është përgjigjur lidhur me kërkesën apo ankesën e tij në afatin e paraparë me ligj ai mund të iniciojë konflikt administrativ duke atakuar për heshtje administrative të organit administrativ, Me padi pala mund të kërkojë:

1. Anulimin ose shpalljen e pavlefshme të vendimit të Komisionit Kombëtar për Refugjat.



## **AFATI PËR PARAQITJEN E PADISË**

Sipas Ligjit për Konfliktin Administrativ, padia paraqitet brenda afatit prej 30 ditësh, nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtarë palës. Ky afat prej 30 ditësh, aplikohet edhe për organin e autorizuar për paraqitjen e padisë, nëse i është dorëzuar akti administrativ.

## **DORËZIMI I PADISË**

Në bazë të nenit 28 të Ligjit për Konfliktin Administrativ padia i dorëzohet gjykatës kompetente drejtpërsëdrejti ose i dërgohet me postë rekomande. Padia mund të bëhet edhe në procesverbal në gjykatë. Dita e paraqitjes së padisë në postë rekomande, respektivisht dita e deklarimit të padisë në procesverbal, konsiderohet si ditë kur i është dorëzuar gjykatës. Nëse padia nuk i është dorëzuar gjykatës por organi tjetër jo kompetent, ndërsa i arrin gjykatës pas skadimit të afatit për paraqitjen e padisë, do të konsiderohet se është paraqitur me kohë, nëse ushtrimi i padisë pranë këtij organi ka qenë si pasojë e mosdijes apo e gabimit të hapur të ushtruesit të padisë. Padiësi duhet t'ia bashkëngjis padisë edhe aktin administrativ. Bashkë me padinë i bashkëngjitet edhe nga një kopje e padisë dhe anekset për organin e paditur dhe për çdo person të interesuar.

## **PËRMBAJTJA E PADISË**

Sipas dispozitës së nenit 30 të Ligjit për Konfliktin Administrativ, padia është parashtrësë formale e cila duhet të përmbajë:

1. Emërtimi i gjykatës të cilës i paraqitet padia,
2. Emri, mbiemri dhe vendbanimi i padiësit dhe të paditurit,
3. Akti administrativ kundër të cilit është iniciuar padia,
4. Arsyet pse ngrihet padia,
5. Vëllimi i anulimit të aktit administrativ.

Në padi nuk është e domosdoshme që të theksohen dispozitat juridike të cilat janë shkelur, por arsyetimi në padi duhet të jetë i kuartë e jo kontradiktor. Kërkesa e padisë është objekt mbi të cilin gjykata shqyrton dhe vendos. Me një padi mund të atakohet vetëm një akt administrativ dhe me padi kontestohet ligjshmëria e aktit administrativ. Kjo është esenca e konfliktit administrativ. Me rastin e ushtrimit të padisë kolektive ekziston atëherë kur shumë persona me një padi e atakojnë të njëjtin akt administrativ.

## **PADIA E PARREGULLT**

Nëse padia nuk e përmban formën e paraparë me Ligjin për Konfliktin Administrativ sipas nenit 30 të po këtij ligji, atëherë gjykata duhet ta zbatoj dispozitën e nenit 33 të Ligjit për Konflikt Administrativ. Kur padia nuk është e plotë e pa kuptueshme ose ka të meta, gjyqtari duhet ta ftoj paditësin që brenda afatit prej 8 ditëve, ti mënjanojë të metat e padisë nga padia jo e plotë dhe e pakuptueshme nuk i ka të gjitha elementet qenësore.

Andaj, me ftesë palës paditëse gjykata duhet t'ia cek udhëzimet për të mënjeluar të metat e padisë dhe paralajmërimin për pasojat që do të lindin nëse nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës. Nëse paditësi, brenda afatit të përcaktuar me njoftim nuk i eliminon të metat e padisë, gjersa ato të meta janë të atilla që e pamundësojnë zhvillimin e drejtë të procedurës. Gjykata kompetente do ta hedhë poshtë me vendim padinë nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm. Gjithashtu gjykata në kuptim të dispozitave të ligjit për konfliktet administrative e hedhë poshtë padinë me vendim nëse konstaton se:

1. Padia është paraqitur pas kalimit të afatit ose është e parakohshme,
2. Akti që kontestohet me padi nuk është akt administrativ,
3. Nga përmbajta e padisë shihet qartë se me aktin administrativ, që kontestohet me padi, nuk preken të drejtat e paditësit ose interesi i tij i drejtpërdrejtë i bazuar në ligj,
4. Kundër aktit administrativ , i cili kontestohet me anë të padisë, mund të bëhet ankimi, kurse ankimi nuk është bërë fare apo nuk është bërë në kohën e duhur,.
5. Është fjala për çështjen sipas dispozitës shprehimore të ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ,
6. Ekziston vendimi i formës së prerë, i nxjerr në konfliktin administrativ për të njëjtën çështje.

## **SEANCA E SHQYRTIMIT KRYESOR NË KONFLIKTIN ADMINISTRATIV**

Karakteristikë themelore e seancës së shqyrtimit kryesor në konfliktin administrativ me rastin e vendosjes sipas padisë është se gjykata në këtë fazë të procedurës vendosë lidhur me kërkesëpadinë duke e zgjidh çështjen kontestuese në konfliktin administrativ (ligjshmërinë e aktit administrativ). Pasi që gjykata nuk e ka hedhë poshtë padinë për shkaqe formale ajo cakton seancën e shqyrtimit kryesor fton palët në mënyrë të rregullt për pjesëmarrjen e tyre në seancë, Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve jo relevante. Në procedurën e konflikteve administrative gjykata mund

të vendos në seancë të mbyllur në rast se mund të zbulohen faktet që kanë të bëjnë me jetën private të palëve, mbi sekretin shtetëror, profesional, tregtar dhe me adoptimin. Nëse ka nevojë ftohen edhe ekspertët lidhur me ndonjë fakt për të cilën gjykata nuk ka dijeni. Në seancë mund të marr pjesë në rast nevojë edhe përkthyesi kur palët nuk kuptojnë gjuhën zyrtare e cila zhvillohet në seancën e shqyrtimit kryesor. Gjykata mund të vendos në çështjen pa shqyrtim verbal, nëse ka fakte të mjaftueshme dhe kur palët kanë dhënë pëlqimin e tyre në formë të shkruar. Gjykata mban seancën e shqyrtimit kryesor publike mirëpo në rast se vendos që të përjashtohet publiku atëherë gjykata është e obliguar që të marr vendim procedural të cilën do t'ia komunikonte palëve. Seancën e shqyrtimit kryesor e udhëheq gjyqtari që e udhëheq çështjen. Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor mbahet procesverbali, në të cilin përfshihen vetëm faktet dhe rrethanat esenciale. Procesverbali përfundon me nënshkrimin e gjyqtarit që ka udhëheqë seancën e shqyrtimit kryesor dhe me nënshkrimin e procesmbajtësit. Mungesa e palës në shqyrtimin verbal nuk e pezullon punën e gjykatës. Për shkak të mungesës së palëve nuk mund të konstatohet se ato nuk kanë hequr dorë nga kërkesat e tyre por do të lexohen parashtresat e tyre. Nëse në shqyrtim nuk vjen as paditësi e as pala e paditur gjersa shqyrtimi nuk shtyhet, gjykata do të shqyrtojë kërkesën për konflikt administrativ edhe pa praninë e palëve.

Gjykata vendosë në seancën e shqyrtimit kryesor në çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative. Nëse gjykata konstaton se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, e që nga faktet vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, ose konstaton se në procedurës administrative nuk janë respektuar rregullat e procedurës, që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes, gjykata do ta anulon me aktgjykim aktin e kontestuar administrativ. Në një rast të tillë në rishqyrtim organi kompetent ka për detyrë të veprojë ashtu si është caktuar në aktgjykim dhe të nxjerr akt të ri administrativ.

Sipas dispozitave të Ligjit për Konflikte Administrative, ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar shqyrtohet nga gjykata brenda kufijve të kërkesës nga padia, por nuk obligohet nga shkaqet e padisë. Gjersa për nulitetin e aktit administrativ gjykata përkujdeset sipas detyrës zyrtare. Për shkak të rëndësisë së pasojave të këtyre akteve administrative Ligji për Konfliktet Administrative e detyron gjykatën që sipas detyrës zyrtare të vlerëson nulitetin e aktit administrativ, pavarësisht se këtë fakt e ka theksuar apo jo paditësi.

Shpallja publike e vendimit të gjykatës, parimisht pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor e cila seancë ka qenë publike, gjykata e shpall aktgjykimin respektivisht vendimin. Në raste të ndërlikuara gjykata mund të heq dorë nga shpallja verbale e aktgjykimin respektivisht vendimit, por jo më vonë se brenda 8 ditësh, të nxjerrë aktgjykimin respektivisht vendimin. Nëse pas përfundimit të shqyrtimit verbal të seancës së shqyrtimit kryesor, gjykata nuk e nxjerrë

aktgjykimin, respektivisht vendimin për arsye se duhet më parë të vërtetojë faktin e atillë për shqyrtimin e të cilit nuk nevojitet një shqyrtim i ri verbal, gjykata do të nxjerr aktgjykimin, respektivisht vendimin brenda 8 ditësh, nga data kur do ta ketë vërtetuar këtë fakt.

## **MJETET JURIDIKE NË KONFLIKTET ADMINISTRATIVE**

Në bazë të ligjit për konfliktet administrative janë përcaktuar mjetet e rregullta juridike-ankesa dhe mjetet e jashtëzakonshme, kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe kërkesa për rishikim.

## **ANKESA NË PROCEDURËN ADMINISTRATIVE GJYQËSORE**

Në procedurën e konflikteve administrative, kundër vendimit të gjykatës mund të ushtrohet mjete i rregullt juridik siç është ankesa, vetëm atëherë kur shprehimisht e ka përcaktuar Ligji për Konfliktet Administrative. Kur ankesa lejohet ajo mund të paraqitet në afat prej 15 ditësh, që nga dita e pranimit të vendimit të gjykatës. Të drejtën e paraqitjes së ankesës kundër aktgjykimit në konflikt administrativ kanë: Pala e paditur, pala paditëse si dhe personi i interesuar. I padituri organi i cili ka nxjerrë vendimin administrativ mund të ushtrojë ankesë kur vendimi i tij është anuluar në konfliktin administrativ. Ankesë mund të paraqes edhe pala paditëse, i cili është i pakënaqur me vendimin gjyqësor të gjykatës për refuzimin e padisë, në rastet kur gjykata refuzon padinë. Ankesë mund të paraqet edhe personi i interesuar, po që se është i pakënaqur me vendimin gjyqësor të nxjerrë në konfliktin administrativ.

## **MJETET E JASHTZAKONSHME JURIDIKE**

Mjetet e jashtëzakonshme juridike palët mund ti shfrytëzojnë pasi që gjykata ka vendosë në mënyrë meritore dhe se aktgjykimi do ta merrte formën e prerë. Ligji për Konfliktet Administrative i ka përcaktuar tri mjete të jashtëzakonshme juridike dhe ato janë:

1. Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor,
2. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe
3. Rishikimi.

## **KARAKTERI I DETYRUESHËM I AKTGJYKIMIT NË KONFLIKTIN ADMINISTRATIV**

Ligji për konfliktet administrative ka përcaktuar se kur gjykata e anulon aktin administrativ, kundër të cilit ka filluar konflikti administrativ, lënda i kthehet të njëjtit organ i cili ka nxjerrë aktin e mëparshëm, të cilin gjykata tani e ka anuluar. Nëse sipas karakterit të çështjes, që ka qenë objekt i konfliktit, duhet që në vend të aktit të anuluar administrativ, të nxirret një tjetër akt sipas vërejtjeve dhe sugjerimeve të cilat i kishte dhënë gjykata me rastin e anulimit të aktit administrativ. Organi kompetent ka për detyrë ta nxjerrë aktin e ri për shtyrje, jo më vonë se brenda 30 ditësh, nga data e dërgimit të aktgjykimit.

Pas nxjerrjes së aktgjykimit, nga ana e gjykatës kompetente në konfliktin administrativ, lindin tri situata të ndryshme dhe atë:

1. Organi vepron në përputhje me vërejtje dhe sugjerime të gjykatës dhe se me atë veprim nxjerr aktin e ri administrativ,
2. Organi kompetent nxjerr akt të ri administrativ në kundërshtim me pikëpamjen juridike të gjykatës të dhënë në aktgjykim dhe
3. Organi në afatin e caktuar fare nuk nxjerr akt të ri administrativ edhe pse ka qenë i detyruar për këtë.

Në qoftë se organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ e nxjerr aktin administrativ në kundërshtim me pikëpamjen juridike të gjykatës, paditësi mund të parashtroj padi të re, gjykata mund të anuloj aktin e kontestuar, me aktgjykim i cili krejtësisht e zëvendëson aktin administrativ të anuluar.

Nëse organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ nuk nxjerr aktin administrativ brenda 30 ditësh, nga data e dërgimit të aktgjykimit, pala me parashtrësë të veçantë mund të kërkojë nxjerrjen e aktit duke kërkuar nga organi administrativ që të veprojë konform dispozitës së nenit 65 të Ligjit për konfliktet administrative. Nëse organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ nuk nxjerrë menjëherë e jo më vonë se 30 ditë, aktin e ri administrativ ose aktin në zbatimin e aktgjykimit të nxjerrë pala mund të kërkojë me parashtrësë të veçantë, nxjerrjen e aktit të tillë.

Nëse organi kompetent nuk e nxjerr aktin brenda 7 ditësh nga kjo kërkesë, pala mund të kërkojë nxjerrjen e aktit të tillë nga gjykata që ka nxjerrë aktgjykimin. Gjykata duke u bazuar në kërkesën e palës do të kërkojë nga organi kompetent njoftimin mbi shkaqet për të cilat organi administrativ nuk e ka nxjerrë aktin e ri. Organi kompetent ka për detyrë ta jap këtë njoftim menjëherë, jo më vonë se brenda 7 ditësh. Nëse organi administrativ nuk e bënë këtë, apo nëse

njoftimi i dhënë sipas mendimit të gjykatës nuk e arsyeton moszbatimin e arsyetimit të gjykatës, gjykata do të nxjerrë vendimin i cili e zëvendëson aktin e organit kompetent. Vendimin e nxjerrë nga gjykata, do t'ia dërgojë organit kompetent që ushtron mbikëqyrjen. Organi administrativ kompetent për ekzekutim ka për detyrë që ta përmbarojë vendimin e gjykatës.

Kur në konfliktin administrativ është nxjerrë aktgjykimi nga ana e gjykatës kompetente, gjersa organi ka nxjerrë aktin administrativ për ekzekutimin e këtij aktgjykimi, por pranë organit kërkohet rishikimi i aktgjykimit për këtë akt administrativ, rishikimi mund të lejohet nëse shkaku i rishikimit ka lindur pranë organit që e ka nxjerrë aktin administrativ.

## **USHTRIME**

Gjatë këtij prezantimi përmes pyetjeve do të nxitet diskutimi por edhe përmes rasteve hipotetike pjesëmarrësit do të angazhohet në zgjedhje praktike të çështjeve që trajtohen në prezantim.

## **PËRMBLEDHJE**

Pas përfundimit të këtij prezantimi pjesëmarrësit kanë përvetësuar njohuri lidhur me zbatimin e dispozitave që kanë të bëjnë me procedurën lidhur me kërkesën e azilkërkuesve të ushtruar pranë Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Komisionit Kombëtar për Refugjatë të Kosovës si dhe për inicimin i Konfliktit Administrativ dhe procedurat pranë gjykatës kompetente.